

# DEMOKRACIA NË REPUBLIKËN TONË



## PËR NJË SHTET DEMOKRATIK

ENDRIT (13), SAMED (13), ALBAN (13), RINESA (13), SHKURTA (13), LEJLA (14), MARIGONA (12),  
ARGJENDA (13)



### Ne mendojmë se demokracia është sistem i qeverisjes që është mirë ta ketë secili shtet

Demokracia është formë e qeverisjes në të cilën populli ushtron sovranitetin e vet, në mënyrë të drejtë-përdrejtë, nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë përfaqësuese, me anë të zgjedhjeve. Demokracia ndahet në demokraci të drejtë-përdrejtë dhe demokraci përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi presidencial dhe ai parlamentar. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë pushtet. Parim i rëndësishëm në demokraci është shprehja e lirë.

Të drejtat themelore të njerëzve janë: e drejta për identitet, e drejta për të pasur familje, e drejta për strehim, e drejta për shkollim etj.

Demokracia për herë të parë është paraqitur në Greqi, përkatësisht në Athinë në vitin 507 para erës së re. E kundërta e demokracisë është diktatura. Diktatura është formë e qeverisjes në të cilën një grup individësh ua kufizojnë të drejtat e popullit. Republika e Kosovës e ka demokracinë përfaqësuese parlamentare. Ne mendojmë se është shumë gjë e mirë që Republika e Kosovës e ka sistemin demokratik të qeverisjes dhe ne jemi të lumtur dhe krenar për këtë fakt.



Gazetarët e demokracisë



Autorët e artikullit

## VOTO SIPAS DEMOKRACISË

VIKTOR (14), PRANVERA (13), EDIAR (13), BLERTA (13), EDMOND (13), ALBANA (13), MINIRE (13)



### Lexues të nderuar, sot do të lexoni më shumë për të drejtën e votës dhe zgjedhjet

Njerëzit në jetë përjetojnë shumë sfida. Njëren ndër sfidat që ata përjetojnë është përzgjedhja që ata bëjnë në jetë. Ndonjëherë jemi shumë vendimmarrës për atë që ne e zgjedhim dhe për atë që ne e mendojmë. Gjatë rritjes, ne më shumë njihemi me botën dhe me gjërat që na rrethojnë. Ne në demokraci mund të zgjedhim personin ideal për të ardhmen e vendit tonë.

Të votosh është shumë e rëndësishme. Me votim ti e shkruan të ardhmen tëndë dhe të ardhmen e popullit tënd. I gjithë populli është i varur nga vota jonë. Nëse votojmë për një deputet që nuk i plotëson kriteret e duhura, atëherë shteti ynë do të shkatërrohet. Çdo person mbi moshën 18 vjeçare, ka të drejtën e votës, pa dallim race, gjinie apo feje.

Janë dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Në zgjedhjet lokale votohen kryetarët e komunës dhe asambleistët, kurse në zgjedhjet qendrore votohen deputetët. Mandati për kryetar dhe për deputet është katër vjet. Por, në qoftë se ka pakënaqësi duhet të bëhen zgjedhje të parakohshme.

Në fillim të paraqitjes së demokracisë, kanë votuar vetëm burrat e pasur. Më pas kanë votuar të gjithë burrat, por jo edhe gratë. Me kalimin e kohës pas shumë protestave kanë filluar të votojnë edhe gratë. Vota e lirë është më e mirë për të ardhmen se sa vota me

dhunë ose jo sips mendimit të vetë individit. Pra, duhet të votojmë lirshëm dhe të jemi realist në votat tona.



Si ka ndryshuar situata nga shek. XVII në shek. XXI



Gazetarët e Republikës së Kosovës

# QYTETARË AKTIV ME TË DREJTA TË BARABARTA

ELVIANA (13), FJOLLA (13), LEONARD (14), ALTINA (13), ARBENITA (13), VALMIR (14), AGONIT (14),  
DORJANA (14)



## Ne sot diskutuam dhe mësuam më shumë se si të jemi qytetarë aktiv, si dhe cilat janë disa nga përgjegjësitë tona

Qytetar quhet çdo individ i cili është i regjistruar në regjistrin civil. Një qytetar i mirë duhet t'i paguaj taksat, të shkojë në punë me rregull, të kujdeset për ambientin, të silltet mirë me të tjerët, etj. Mirëpo, ne si qytetarë edhe mund të jemi aktiv.

Si mund të jemi qytetarë aktiv? Qytetarë aktiv mund të jemi në shumë mënyra, si për shembull, mund të jemi aktiv në komunitetin ku jetojmë, duke punuar gjithmonë në të mirë të atij komuniteti. Të gjithë këtë mund ta bëjmë duke marrë iniciativa. Ndoshta mund të jetë një ditë pastrimi në komunitet.

Por qytetarë aktiv përveç në qytetin tonë mund të jemi edhe në nivele të tjera, si në nivel të komunës. Ne si qytetarë dhe fëmijë aktiv mund të organizojmë, në një ditë vikendi të dalim dhe ta pastrojmë komunën tonë,

Prishtinën, e kështu me radhë.

Nga kjo që po e shkruajmë, ne po nënkuptojmë se disa nga këto që i cekëm më lart janë edhe përgjegjësitë tona si qytetarë, por edhe si fëmijë. Disa nga përgjegjësitë tona janë: të shkojmë me rregull në shkollë, kur të bie zilja për të hyrë në klasë mos të vrapojmë, të mos kopjojmë nga shokët, etj. Duke kryer përgjegjësitë tona, ne arrijmë qëllimin tonë. Sepse ne fëmijët jemi e ardhmja e atdheut.



Qytetarët aktiv duke mirëmbajtur mjedisin



Autorët e artikullit



Me këtë vizatim duam të paraqesim se si një pjesë e shoqërisë me apo pa dashje dallohet nga pjesa tjetër. Pra, edhe kur je i lumtur duhet të mendosh për të tjerët. Të gjithë fëmijët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë

Ne si nxënës të klasës së VIII-të, do t'iu tregojmë më shumë rreth të drejtave tona si fëmijë, si dhe nga kush janë të mbrojtura ato. Jo vetëm fëmijët kanë të drejta, por secila qenie njerëzore ka të drejtat e veta që kur fillojnë jetën. Secila foshnje kur lind ka të drejtën të ketë emër, të ketë familje, të ketë strehim, ushqim, etj. Të gjitha këto të drejta që ne i cekëm janë të përmendura në Konventën e të Drejtëve të Fëmijëve, e cila ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 1990. Që nga ajo kohë e deri më tash, ne si fëmijë kemi gëzuar shumë të drejta. Po ashtu, gëzojmë edhe këto të drejta si: e drejta për t'u mos diskriminuar nga të tjerët dhe e drejta për t'u shprehur lirshëm. Ne mendojmë se këto janë të drejtat bazë për ne si fëmijë.



Konventa e të Drejtëve të Fëmijëve



Ne mendojmë se të gjithë duhet të jemi të barabartë




Një e drejtë tjetër jona është të jemi të lumtur

# NDARJA E PËRGJEGJËSIVE NË DEMOKRACI

RONITA (13), DONIKA (14), ARION (13), ADEM (13), ALBON (13), GENTIANA (14), RREZARTA (13),

AFËRDITA (14)



## Ne jemi gazetarët e grupit i cili diskutoi gjatë Punëtorisë për ndarjen e pushtetit në Kosovë

Gjatë diskutimit ne filluam të flisnim për demokracinë. Demokracia është formë e udhëheqjes së një vendi. Fjala demokraci rrjedhë nga gjuha greke apo fjalët greke, që do të thotë „demos“ populli dhe „kratia“ udhëheqje. Demokracia u paraqit gjatë vitit 507 para lindjes së Krishtit në kryqytetin e Greqisë, Athinë. Demokracia ndahet në demokraci përfaqësuese dhe demokraci direkte. Në Kosovë, ne kemi demokracinë përfaqësuese si formë të udhëheqjes së popullit tonë. Si institucion të rëndësishëm ne e kemi Kuvendin e Kosovës. Pushteti në Kosovë ndahet në tri degë kryesore: në degën legjislative, ekzekutive, dhe dega gjyqësore.


Në Kuvendin e Kosovës gjenden 120 deputetë, ku 100

prej tyre janë qytetarë shumicë, 10 prej tyre janë serbë, dhe 10 të tjerë janë të komuniteteve të tjera jo shumicë që jetojnë në Kosovë. Kuvendi përbëhet prej dy grupeve: pozitës dhe opozitës. Pozita është partia që ka fituar më së shumti vota. Kurse, opozita janë partitë që kanë më pak vota të fituara. Ky institucion përbën degën legjislative të pushtetit në Kosovë. Kuvendi i Kosovës ka për detyrë kryesore miratimin e ligjeve me të cilat funksionon shteti i Kosovës.

Në degën ekzekutive bën pjesë Qeveria. Detyra e kësaj dege është zbatimi i ligjeve të miratura nga Kuvendi i Kosovës. Ndërsa, në degën gjyqësore bëjnë pjesë gjykatat e Kosovës. Kemi disa lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, e Apelit, Supreme, dhe Gjykata Kushtetuese. Detyra e të gjitha gjykatave është vendosja e drejtësisë në vend.



Fëmijët gazetarë




Degët e pushtetit në Kosovë


**Pse duhet të ndahet pushteti dhe pse duhet të ndahen punët në demokracinë e Kosovës?**

Sipas nesh, pushteti duhet të ndahet sepse është më mirë për ne, si qytetarë të Kosovës.


Ne mendojmë se nëse do të ndaheshin punët, do të ishte më e lehtë për të gjithë qytetarët. Nëse ne do të kishim detyrën e pastrimit të dhomës së klasës, ne do t'i ndanim punët në mes vete. Njëri do të merrte pastrimin e dollapeve, njëri do të pastronte bankat, tjetri do të pastronte dyshemenë, e disa të tjerë dritaret e klasës. Kështu, puna do të bëhej shumë më e lehtë, dhe ne do ta pastronim dhomën shumë më shpejt. Ashtu si në klasën tonë, edhe në demokraci do të ndodhte e njëjta. Kur punët ndahen, askush nga ne nuk do të lodhej edhe aq shumë. Gjithashtu, me ndarjen e punëve secili prej nesh do të kishte përgjegjësi mbi atë punë. Andaj, duhet që të ndajmë punët së bashku dhe në të njëjtën kohë të punojmë së bashku që të arrijmë një qëllim sa më të mirë.




Gjykata Supreme




Pema e pushtetit



Ja se si ndahet pushteti në Kosovë



Mendimet tona mbi temën e diskutimit



Lulja me ndarjen e pushtetit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Hilmi Rakovica“  
Klasa: VIII-1  
Vendi: Prishtinë